



REPUBLIKË E SHqipërisë

BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE JURIDIKE
SEKTORI I SEKRETARI-ARKIVIT

KARTELË SHOOËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues Prefekti i Qarkut Fier Nr. Prot. 1097/, Data 12.10.2023
Shkurtimi i lëndës Jethim papillore LP(13)

Për trajtim nga:	<u>Z. Bealvis Heeto</u>
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	<u>Z. Mleuto</u> <u>16.10.2023</u>

Afati: normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (Brenda ditës) Pa afat/ për dijeni Tjetër ___ ditë

Data 13.10.2023 Nr. Prot. 2513/

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi: (TITULLARI) _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ Nënshkrimi _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____ Nënshkrimi _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____

Kalon për trajtim (struktura): _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1047 / Prot.

Fier, më 12.10.2023

Lënda: Kthim përgjigje për verifikimin e ligjshmërisë së vendimit Nr. 86, të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 29.09.2023.

BASHKISË ROSKOVEC
KËSHILLIT TË BASHKISË ROSKOVEC

Roskovec

Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 5913 prot. datë 02.10.2023, protokolluar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier me Nr. 1047 prot. datë 09.10.2023, bazuar në ligjin Nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut" neni 8, shkronja "a", neni 16, si dhe në ligjin Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3, pika 2, shqyrtuam ligjshmërinë e vendimit me karakter normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, të miratuar në mbledhjen e datës 29.09.2023, shoqëruar me procesverbalin e mbledhjes Nr. 12, datë 29.09.2023, të mbajtur në Librin e Procesverbalit të Mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec me Nr. 112, prot. datë 10.01.2023, si dhe dokumentacionin plotësues të vendimit, shprehemi si më poshtë:

Vendimi i Këshillit të Bashkisë Roskovec Nr. 86, datë 29.09.2023, "Për miratimin e dokumentit të PBA 2024-2026 të rishikuar" shoqëruar nga projektvendimi Nr. 86, datë 22.09.2023, protokolluar me Nr. 5707 prot. datë 22.09.2023, relacioni shpjegues Nr. 5707/1 prot. datë 22.09.2023, është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 41, pika 1; Ligjin Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore" (i ndryshuar), neni 6, shkronja "ç", neni 38; Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar) neni 4, neni 26; Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 23, datë

30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar) si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 6, datë 28.02.2023, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

Lefter Shehaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5909 Prot.

Roskovec, më 02.10 2023

VENDIM

NR 83. DATË 29.09. 2023

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MUAJIN GUSHT 2023”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.08.2023, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Gusht 2023.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5105/2 Prot.

Roskovec, më 30.08.2023

Procesverbal Nr.11

-I mbajtur sot, datë 29.08.2023, ora 13⁰⁰, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2023.
5. Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
6. Për miratim fondi i kushtëzuar për investime në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13¹⁰

Këshilltarët prezent: E.Musko, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, Zh.Metushi, E.Kaçeli, Z.Zeka, H.Hajdini, E.Toska, Dh.Malka, J.Begaj, A.Hoxha, S.Bibo, Rr.Hazizi.

Këshilltarët që mungojnë : A.Plaka, E.Buzi, E.Xhaxhaj, P.Toro, V.Çepele, A.Pelo, F.Feleqi.

Prezent nga bashkia: Nënkyetari M.Goga, Dr.Ekonomisë S.Çepele, P/Shërbimit Social S.Saliaj.

Me plotësimin e kuorumit, Zëvendëskryetarja Sara Bibo hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 14 këshilltarë. Sara sqaron se në mungesë të Kryetarit të Këshillit A.Plaka dhe Zëvendëskryetares E.Buzi, në bazë të ligjit dhe të rregullores së këshillit, mbledhjen e sotme do e drejtojë unë, në cilësinë e Zëvendëskryetares. Mbledhja e sotme po transmetohet live në faqen e facebookut të Këshillit Bashkiak. Zëvendëskryetarja fillon mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Hidhet në votim rendi i ditës dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së kaluar.

Informacioni ka të bëj me vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar,ndarjen e akteve normative,dërgimin e tyre në Prefekturë dhe miratimi i tyre nga Prefektura.Vendimet u janë dhënë zyrtare për zbatim.

3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Hidhet në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

4.Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2023.

Elmazi-për 6% është thënë e stërthënë,por a ka ardhur ndonjë shkresë për këto familje, për rritje të pagesës ?Sidorela-jo,akoma nuk ka ardhur.Elmazi-a ka të drejtë bashkia të kërkojë në këtë drejtim?Sidorela-këto janë vendime që i merr qeveria.Elmazi-në emër të grupit nuk kemi asnjë vërejtje,ne e kalojmë këtë projekt-vendim.Nuk ka më diskutime.Hidhet në votim projekt-vendimi i 6% për muajin Korrik 2023 dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro.

5.Për miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2023.

Dr.Financës S.Çepele sqaron projekt-vendimin.Sqaron fondin për objektin e blerjes së një mjeti për administratën e bashkisë,si dhe ndarjen e fondit për 2023 dhe 2024.Sqaron tabelën me detajimet përkatëse si dhe relacionin e komisionit.Shton se mjeti është i amortizuar në vite,i ka kaluar afati i përdorimit si mjet në kontabilitet,dhe riparimi i tij kërkon fonde më shumë.Jorgo-kjo makina që rri aty para,duhet dhe një tjetër që ta shoqërojë?Ky fond e kuptoni se çfarë është?Do konkurojmë Kryeministrin me këtë blerje?Ne e njohim tregun,ky mjet përse do shërbej,kur nja 2 a 3 rrinë aty vërdallë bashkisë?Maksi-sa i përket punës së bashkisë,janë gati 9 vite dhe është punuar me mjete që bashkia i ka trashëguar në 2015.Të dyja mjetet e kanë kaluar kohën e amortizimit,kanë mbi 25 vjet si mjete.Në këto kushte të ndodhur pa mjet,jemi të detyruar ti drejtohem këshillit të bashkisë për një mjet.Më mirë të marrim një gjë të shtrenjtë ta kemi për gjithë kohën,sesa një të përdorur.Riparimi i tyre harxhon shumë,amortizimi i tyre e ka kaluar kohën sipas ligjit.Jorgo-këto 2 mjete të cilit vit janë?Se si këto mjete kemi edhe ne dhe i kemi në gjendje të rregullt.Selmani-janë mjete të përdorura,të blera në 2011.Jorgo-me kaq lekë gjen mjet kudo,ju do e blini të re nga fabrika?Selmani-po,do blihet e re.Amarildo-ju po kërkon makinë luksi për të shoqëruar administratën në punët e veta?Të marrësh një makinë me kaq lekë mua më duket e tepëruar,jashtë llogjike.Në këtë gjendje që është ky popull,ju kërkon të lëvizni administratën me makinë me kilometrazh zero?Pse duhet të bëni shpenzime të tilla,ky është një abuzim,ju po ja kaloni edhe Kryeministrin.Sugjeroj ta rishikoni edhe njëherë,ne do bëjmë denoncimin tonë,është jashtë çdo llogjike që një bashki e zhytur në borxhe,të marri një makinë me këtë vlerë,duke e ditur që ka shumë familje në nevojë.Ato lekë që ju i keni marr nga rrugët,duke i lënë dhe rrugët-rrugëve,ti menaxhoni duke ndihmuar familjet në nevojë.Dhurata-ju mendoni se i keni riparuar të gjitha rrugët e bashkisë?Maksi-ky fond është kursim i lekëve të fituara nëpërmjet tenderimit të rregullt.Amarildo-ne nuk po kundërshtojmë pse do blini makinë,të gjithë kemi nga një makinë,e dimë shumë mirë që një makinë e euro pesës e 2010 është brenda kushteve teknike,dhe ajo me kilometrazh zero të njëjtin amortizim do ketë.Elmazi-duke parë mjetet që bashkia ka,amortizimin e tyre,shërbimet që u bëhen këtyre mjeteve,që ja kalon bishti sqeparit siç thotë populli,nuk është e tepërt për një bashki të blihet një mjet që i shërben administratës në territorin e bashkisë.Mos ti shikojmë gjërat me syrin politik,por si i shërben komunitetit ky problem.Kemi 8 vjet në bashki,dhe ne nuk gjetëm ndonjë rrugë të bërë,është merita e kësaj bashkie dhe e këtyre punonjësve për punën që është bërë.Nëse do e donte Kryetarja personale do isha me ju,por nuk është e vërtetë,prandaj

them ta kalojmë të gjithë bashkë këtë projekt. Maksi-para 10 viteve ato makina janë marr me të njëjtën vlerë sa do blejmë ne sot pas 10 viteve. Leksi-të kishim një material shpjegues për makinat aktuale, si janë blerë, me çfarë çmimi, koha e amortizimit sa ka kaluar, sa shpenzojmë në vit për këto makina? Komisioni të na tregonte edhe tipin e makinës që do blihet. Shifra në pamje të parë duket e madhe, por në qoftë se është me kilometrazh zero besoj ia arrin qëllimit. Unë jam dakort që kjo makinë të blihet por të shpjegohet ca tipi është makina. Jorgo-shikojeni edhe njëherë. Hidhet në votim projekti sipas materialit dhe miratohet me 11 vota pro, 3 vota kundër J. Begaj, A. Hoxha, Dh. Malka. Miratohet me shumicë votash.

6. Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Rosovec për vitin 2023.

J. Begaj dhe A. Hoxha ikin nga mbledhja. Sekretarja sqaron se për këtë projekt kemi një saktësim të titullit, i cili do jetë “Për një shtesë në buxhetin e Bashkisë Rosovec për vitin 2023”. Selmani-ky projekt-vendim bën fjalë për fondin e kushtëzuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për blerje pajisje mobilierie për shkollën 9-vjeçare “5 Dëshmorët” Suk 1, sipas vlerës që keni në projekt. Bëhet fjalë për shkollën e cila është në përfundim të rikonstruksionit dhe do pajiset me këto mjete, të cilat i keni të gjitha sipas specifikimeve teknike. Maksi-fondi është miratuar nga qeveria për ti blerë Ministria, por në kushtet që Ministria ja ka kaluar bashkisë, në një konferencë që patëm me Ministrinë, u kërkua që blerja me këtë fond të bëhet me procedurë të përshpejtuar. Shkolla do pajiset me materiale të reja sipas specifikimeve të Ministrisë. Në lidhje me riparimin e shkollave, ka mbaruar procedura e tenderimit, është shpallur fituesi, është lidhur kontrata dhe ka filluar puna. Brenda datës 11 ne i kemi të gjitha mundësitë që shkollat të fillojnë me riparime të reja. Dhurata-kur u paraqit stafi i shkollës Suk 1, atje asgjë nuk ishte bërë. Maksi-sepse dje filloi puna. Dhurata-për këtë projektin sot, pas miratimit tonë, sa kohe duhet që të vijnë materialet? Materialet nuk janë në raport të drejtë me ato që duhen, por ne i gezojmë të paktës, por të paktën në datën 11 të vemi atje. Maksi-do mundohemi me të gjitha mënyrat, por gjithmonë sipas procedurave ligjore. Ne do mundohemi me çdo kusht të arrijmë afate sa më të shkurtra, por gjithmonë duke zbatuar ligjin. Për këtë problem Ministria kërkoi falje që nuk u bë më shpejtë. Hidhet në votim projekt-vendimi sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Dhurata-në lidhje me transportin e nxënësve, ligji është mbi 2 km subvencionohen, po nxënësit që vijnë nga Agaçaj rreth 700 m larg? Maksi-ky problem nuk është në kompetencën e këshillit dhe as ekzekutivit për ta zgjidhur, por do shkojmë në Drejtorinë Arsimore për ta zgjidhur këtë problem sipas ligjit në fuqi. Nazmiu-subvencioni jepet për largësi 2 km nga fshati në fshat, por brenda fshatit edhe sikur të jetë 5 km nuk jepet. Maksi-këtë problem mund ta zgjidhim me autobuzat e linjës, por subvencion nuk japim dot se nuk është në kompetencën tonë. Dhurata-mund ta zgjidhim këtë gjë se do na ikin nxënësit? Maksi-do e zgjidhim menjëherë. Elizabeta Kaçeli-stolat në oborrin e shkollës janë të thyer, të konsumuar dhe duhen riparuar. E mira është që të shtohen edhe disa të tjerë, se janë shumë pak stola në krahasim me numrin e nxënësve që shkolla jonë ka. Në lidhje me lysterjen, nuk e di nëse do jetë gati shkolla në datën 11? Leksi-mbledhjen e kaluar fola për çështjen e efektit financiar të rritjes së pagave nga 01.04.2023. Drejtori i financës është në gjendje të na e shpjegojë nëse shtesa e pagës së këshilltarëve do kalojë nga 01.04.2023? Është gjynah që për 36 mijë lekë të reja të mos kalojnë nga 1 prilli 2023, edhe për ata këshilltarë që kanë ikur. Vendimi e thotë qartë e zeza mbi të bardhën. Elmazi-punonjësit e policisë bashkiake duhet të jenë në qarkullim për gjrobat, për vendet që zihen në territorin tonë. Ska punë polici i Fierit apo të rendit, kur ne kemi polici

bashkiake.Nuk e di si funksionon,por e vërteta është që policat rrinë më shumë tek dera.Për ne këshilltarët na lejoni që ditën e mbledhjes të hyjmë brenda me makinë tek sheshi,se dhe ne jemi pjesë e administratës.Maksi-policia bashkiake kompetencat i ka të përcaktuara me ligj.Për parkimin ke të drejtë.Elizabeta Kaçeli-ka mjete që nuk lëvizin fare nëpër lagje,me muaj e vite,të cilat zënë trotuaret dhe ne kemi vështirësi për të kaluar,duhet bërë diçka.Të rishikohet edhe pak pastrimi i barërave të këqia në lagje.Esmeralda-ankesë nga banorët në Strum për derdhjen e ujërave të zeza në kanal in sa hyn në Strum.Zëvendëskryetarja mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Zv/Kryetar

Sara Bibo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5910 prot

Roskovec, më 02 . 10 .2023

VENDIM

Nr. 84 datë 29/09/2023

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR
DERI 6% PËR PERIU DHËN 1-31 GUSHT 2023**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 8 pika 2,9,24, të nenit 21 të Ligjit nr. 57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe”, në pikën 2, 3, 6, 9, dhe 10 të Kreut IV të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmëse ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB Nr.3 datë 27.01.2023 “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin **Gusht 2023**, në total **14 (katërmëdhjetë)** familje me fond total prej **65567 (gjashtëdhjetë e pesëmijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë)** lekë. Konkretisht:

PËR BANORËT E QENDRËS SË BASHKISË ROSKOVEC

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Gusht 2023, **3 (tre)** familje me një fond **8470 (tetëmijë e katërqind e shtatëdhjetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJESISË ADMINISTRATIVE STRUM

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Gusht 2023, **1 (një)** familje me një fond **2178 (dymijë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Gusht 2023, **2 (dy)** familje me një fond **10098 (dhjetëmijë e nëntëdhjetë e tetë)** lekë.

PËR BANORËT E NJËSISË ADMINISTRATIVE KURJAN

Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Gusht 2023, **8 (tetë)** familje me një fond **44821 (dyzetë e katërmijë e tetëqind e njëzetë e një)** lekë.

- Ngarkohet sektori i Financës dhe sektori i Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Afrim Plaka



Bashkia Roskovec
Gusht 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr. dosje	Nr. Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Agron Osmën Çanta		1	Familje në nevojë	2178
2	Bukuroshe Sali Çepele		1	Familje në nevojë	3146
3	Selvi Rystem Çepele		1	Familje në nevojë	3146
	Shuma				8470

Mbyllet me nr rendor 3 (tre)



Njësia Administrative Strum
Gusht 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Afesi Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës ndihmes	Shuma
1	Drita Mehmet Cepele		1	Familje në nevojë	2178
	SHUMA				2178

Mbyllet me numrin rendor 1 (një)



Njësia Administrative Kuman
Gusht 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emër Atesit Mbiemër	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	ndihmes	Shuma
1	Eugerta Medin Satëri		3	Familje në nevojë	7920
2	Aishe Jonus Akulli		1	Familje në nevojë	2178
2	Shuma				10098

Mbyllet me nr rendor 2(dy)



Njësia Administrative Kurjan
Gusht 2023

FAMILJET QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR DERI NË 6%.

Nr	Emer Atesi Mbiemer	Nr.dosjes	Nr.Frymeve	Lloji i ndihmës	Shuma
1	Yzedin Shaban Panahori		2	Familje në nevojë	3703
2	Agim Mino Zeka		5	Familje në nevojë	14652
3	Donika Vexhi Kuka		1	Familje në nevojë	3146
4	Ludjana Namik Shabanaj		3	Familje në nevojë	7920
5	Ramadan Gani Koronaj		1	Familje në nevojë	5720
6	Donika Hysni Lika		1	Familje në nevojë	2178
7	Gëzim Hysen Goriçani		1	Familje në nevojë	3146
8	Kamber Riza Lamaj		3	Familje në nevojë	4356
	Shuma				44821

Mbyllet me nr rendor 8 (tetë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 59/11 prot.

Roskovec, më 02.10.2023

VENDIM

NR 85 .DATË 29.09 .2023

**“PËR FALJEN E TARIFËS PËR MIRËMBAJTJEN E INFRASTRUKTURËS SË
UJITJES DHE KULLIMIT PËR VITIN 2023 PËR FERMERËT TË CILËT JANË
ANËTARË TË ODËS SË BUJQËSISË”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f ,të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, pika 2, si dhe në rëndësinë që ka për zhvillimin e bujqësisë lokale ndërmarrja e këtyre nismave; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Faljen e tarifës për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit për vitin 2023 për fermerët të cilët janë anëtarët e krijimit të Odës së Bujqësisë sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Afrim Plaka





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5912 Prot.

Roskovec, më 08, 10 2023

VENDIM

NR 86, DATË 29.09.2023

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË PBA 2024-2026 TË RISHIKUAR”

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, të ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të ligjit Nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjen vendore” ,të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Programimit Buxhetor Afatmesëm”të ndryshuar me udhëzimin Nr.7 datë 25.02.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr.23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Programimit Buxhetor Afatmesëm”;të Udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” si dhe materjaleve të sjella nga Drejtoria Ekonomike , Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin për Programin Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 të rishikuar për Bashkinë Roskovec dhe 2 njësitë shpenzuese në vartësi, sipas tabelave në formatet output dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë bashkëlidhur :
 - Tabelën 1 “Tavanet e Programeve Buxhetore”;
 - Tabelën 2 “Burimet Buxhetore”;
 - Tabelën 3-5 “Shpenzimet sipas kategorive ekonomike”;
 - Tabelën 4 “Shpenzimet sipas klasifikimit funksional”
 - Tabelën 4.1 “Shpenzimet sipas programeve”;
 - Tabelën 6 “Deklarata e politikës së programeve”;
 - Tabelën 7 “Shpenzime e produkteve të programeve”;
 - Tabelën 8 “Projektet e Investimeve”;
 - Tabelën 9 “Të dhënat bazë mbi programet”;

- Relacion shpjegues për procesin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm (Shtojca 2,Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026).
- 2. Ngarkohet Ekzekutivi i bashkisë për zbatimin e këtij vendimi për vazhdimin e punës së mëtejshme të përgatitjes së PBA 2024-2026 sipas këtij dokumenti.
- 3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

